QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 5716 Prot.
Datë 18. 4. 2019

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT**
**SHOQËRIA PËRMBARIMORE "STUDIO PEMA"**

Nr.906 Prot. Tirane më, 16.04.2019

## URDHËR

## PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

**Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT**

Në Tirane sot më, 16.04.2019

Unë Elvis Sulkuqi, Përmbarues Gjyqësor dhe Administrator i Shoqërisë Përmbarimore "STUDIO PEMA" sh.p.k, pasi studiova dosjen përmbarimore si dhe në zbatim të;

Urdhrit të Ekzekutimit nr.8473, datë 26.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
Urdhrit të Ekzekutimit nr.8471 dt.24.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
Urdhrit të Ekzekutimit nr.6808, dt.27.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
Urdhrit të Ekzekutimit nr.6807, dt.7.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
Urdhrit të Ekzekutimit nr.6809,dt.27.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

## KONSTATOVA

Se në datën 16.11.2018 Kreditori UKT sh.a (Ujësjellës Kanalizime Tiranë) ka paraqitur pranë Shoqërisë Përmbarimore "STUDIO PEMA" sh.p.k kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv nr.

147807-1/faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, për periudhën Qershor 2013 – Korrik 2018, për të cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 8473, datë 26.10.2018 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;

196367-1/faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, për periudhën qershor2017 - korrik 2018 për të cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 8471, datë 24.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë:

370778-1/faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, për periudhën Dhjetor 2013-Prill 2018, për të cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 6808, datë 27.07.2018 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,

383555-1/faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, për periudhën Prill 2015-Prill 2018, për të cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 6807, datë 07.09.2018 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "STUDIO PEMA"

370777-1/faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, për periudhën Qershor 2013 – Korrik 2018, për të cilin jane lëshuar Urdhrerat e Ekzekutimit te sipercituar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,

**Kreditor** : UKT sh.a (Ujësjellës Kanalizime Tiranë)
**Debitor** : Alcred Food Processing shpk nipt J81426006C
**Me objekt** : Pagim Detyrimi (Fatura të papaguara të konsumittë ujit të pijshëm)

Në Vendimet e sipërcituara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur detyrimi i palës debitore Alcred Food Processing shpk nipt J81426006C, të përmbushë detyrimet duke bërë pagesën e faturave të papaguara të konsumit të ujit të pijshëm për periudhën Qershor 2013 – Korrik 2018, në favor të kreditorit UKT sh.a.

Me vendimin e Përmbaruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titujve Ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte, për ekzekutimin e Urdhërave te Ekzekutimit të sipërcituar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të kryhet bllokimi i aksioneve të debitorit, me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi.

Sa më lart, si dhe mbështetur në nenet **527 të Kodit Proçedurës Civile në nenin 31 gërma b dhe nenin 46 të Ligjit nr.10031 datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"**

## URDHËROJMË

1. Vënien e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit Alcred Food Processing shpk nipt J81426006C me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi për ekzekutimin e Titujve Ekzekutiv/ faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të Kodit të Proçedurës Civile.
4. Ky urdhër mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brënda 5 ditëve.

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE "STUDIO PEMA" sh.p.k**

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**ELVIS SULKUQI**

Adresa: Rruga Reshit Collaku, Pallati I ri, Hyrja 1, Kati 3/1. pranëSky Hotel 2. Phone: +355696059520
email: bailiffstudiopema@gmail.com